

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Summer 6-2010

Politikat Fiskale në Kosovë

Ajete Kosumi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

Recommended Citation

Kosumi, Ajete, "Politikat Fiskale në Kosovë" (2010). *Theses and Dissertations*. 2465.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2465>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Politikat Fiskale në Kosovë
Punim Diplome

Ajete Kosumi

Qershor/2010
Prishtinë



Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Tema e Diplamës
Viti Akademik 2007/2008

Ajete Kosumi

Politikat Fiskale në Kosovë

Mentori: Nazmi Zeqiri

Qershor/2010

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT.....	4
FALEMINDERIMET.....	5
PËRMBAJTJA	
1. HYRJA.....	6
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	7
2.1. Objektivat e politikës fiskale.....	9
2.1.1. Instrumentet dhe efektet e politikës fiskale.....	10
2.1.2. Ekonomia e tregut dhe ndërhyrja e shtetit në rregullimin e Politikës Fiskale.....	14
2.1.3. Sfidat e Politikës Fiskale në Kosovë.....	17
2.1.4. Disa analiza të efekteve globale ekonomike në ekonominë e Kosovës	22
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	25
4. METODOLOGJIA.....	27
5. REZULTATET.....	28
6. KONKLuzionET.....	32
7. REKOMANDIMET.....	34
8. REFERENCAT.....	35
9. SHITESAT.....	36

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij Punimi Diplome është të kuptojmë ndikimin dhe rolin e Politikave Fiskale në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e politikave fiskale në zhvillimin ekonomik të vendit me anë të këtij punimi do të mundohemi të rekomandojmë një politikë të qëndrueshme fiskale që do të zhvillohej me kombinimin e ndryshimeve të sistemit ekzistues dhe inkuadrimit të komponenteve të reja siç janë:

- Harmonizimi i ngarkesës fiskale në mes të komunitetit të biznesit dhe popullatës,
- Mbështetja më e madhe e saj në nevojat e zhvillimit ekonomik të Kosovës
- Një politikë e tillë të jetë në funksion të ndërtimit ekonomik të Kosovës.

Duke pasur parasysh mungesën e literaturës të dhënat dhe informatat e përdorura janë mbledhur nga artikuj të ndryshëm nga interneti, gazetate ditore si dhe publikime të ndryshme nga Oda Ekonomike e Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Banka Qëndrore dhe nga institutet për hulumtim Riinvest dhe Gap. Si burim i dytë ishte intervista e realizuar me anë të pyetësori, i cili është i ndarë në disa kapituj duke u bazuar në fushat nga të cilat mund të rrjedhin barrierat për bizneset (përfshirë këtu: tatimet, doganat, sistemin bankar etj).

Pikat kyçe në të cilat është fokusuar punimi kanë të bëjnë kryesisht me ruajtjen e qëndrueshmërisë buxhetore dhe fiskale si dhe efekti i normave tatimore në ndërmarrjet e Kosovës.

FALEMINDERIMET

Duke qenë në dijeni se familja si nxitësi më i madh në arsimimin e një personi njëherit ka rol të madh por edhe të fuqishëm. Kam një mirënjohje të thellë ndaj familjes sime pasi që asnjëherë nuk kanë kursyer ndihmën e tyre në kurrfarë aspekti dhe më kanë mbështetur edhe në momentet kur unë humbja shpresat.

Faleminderim i veçant i kushtohet Universitetit për Biznes dhe Teknologji, që gjatë tri viteve të studimeve më dha mundësinë e një zgjedhje mjaft racionale për t'i përfunduar studimet pasi që me njohuritë që kam fituar gjatë studimeve kam kaluar një rrugë të gjatë drejt formimit tim profesional. Aplikimi i këtyre njohurive po gjen zbatim të madh në tregun e punës gjë që po më ndihmon shumë për një planifikim më të suksesshëm të karrierës sime në vazhdim.

Gjithmonë do të kemë mirënjohje për të gjithë ata që kanë dhënë një kontribut drejt rrugës sime të nisur. Profesorët janë ata të cilët në shumë mënyra drejtojnë dijen tonë dhe si rezultat të saj dhe karrierat tona. Jam shumë faleminderuese për të gjithë profesorët për kontributin që kanë dhënë drejt aftësisë tim profesional e faleminderim të veçant sidomos për Mentorin e temës time Profesor Nazmi Zeqirin për ndihmën dhe sygjerimet e dhëna gjatë punës.

1. HYRJA

Duke e ditur se politika tatimore është një prej elementeve të një lëmie më të gjerë siç është politika fiskale, do të përpiqemi që në këtë punim të veçojmë disa çështje të cilat mendojmë se janë më të rëndësishme, megjithatë një nga konstatimet e deri tanishme për politikën aktuale tatimore në Kosovë është mungesa e një strategjie dhe vizioni të mirëfillt për të balancuar në mënyrë më të qartë ngarkesat fiskale në mes të komunitetit të biznesit dhe të popullatës. Prandaj në këtë punim do të bëjmë përpjekje që përmes sigurimit të materialit dokumentues dhe informativ që i referohet politikës fiskale të ndihmojë në pasqyrimin dhe vlerësimin sa më të plotë të gjendjes së tatimeve dhe detyrimeve tjera fiskale.

Duke pasur parasysh rëndësinë e politikave fiskale në zhvillimin ekonomik të vendit si qëllim i këtij punimi do të jete të rekomandojë një politikë të qëndrueshme fiskale që do të zhvillohej me kombinimin e ndryshimeve të sistemit ekzistues dhe inkuadrimit e komponentëve të reja siç janë: Harmonizimi i ngarkesës fiskale në mes të komunitetit të biznesit dhe popullatës, Mbështetja më e madhe e saj në nevojat e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe të jetë në funksion të ndërtimit ekonomik të Kosovës.

Duke u bazuar në librin Fjalor Ekonomiko – Financiar të shkruar nga Pano, (2002)¹ thuhet se vendimet lidhur me politikat fiskale në masë të madhe varen nga rrethanat politike si besueshmëria dhe roli që luan qeveria në ekonomi por edhe nga reagimet publike lidhur me drejtimin dhe veprimet e qeverisë. Vendimet e tilla mund të ndikohen edhe nga faktorët e jashtëm që do të thotë se qeveria duhet të merr parasysh trendet globale ekonomike.

Përderisa në këtë pjesë hyrëse u paraqit qëllimi i këtij punimi dhe rëndësia e politikave fiskale për një vend si Kosova, pjesa në vazhdim do të paraqet pasqyrën nga literatura dhe të diskutojë rëndësinë e zhvillimit të politikave fiskale për një vend.

¹ Pano, A. (2002). Fjalor Ekonomiko- Financiar, Albin, 2002, Tirane.

2. SHQYRTIMI I LITERATURES

Me termin politikë fiskale nënkuptojmë mënyrën se si qeveria zgjedh të shpenzojë buxhetin e saj me qëllim të furnizimit të qytetarëve me shërbime dhe mallra publike. Këto mallra dhe shërbime përfshijnë infrastrukturën publike, edukimin, shëndetësinë, sigurinë publike, gjyqësinë etj. Qeveria përpiket t'i gjejë metodat më të mira për financimin e këtyre shpenzimeve nëpërmjet llojeve të ndryshme të tatimeve si: TVSH, taksat doganore, tatimet në të hyra personale, tatimi në të hyra të korporatave, kontributet për sigurimin social etj. Gjatë zbatimit të politikave tatimore, qeveria mundohet që të sigurojë nivel të ulët të ngarkesave tatimore dhe trajtim të barabartë si për biznese, ashtu dhe për qytetarë. (*Mancellari, Haderi, Kule, Qirici, 1999, faqe 396*).

Shpenzimet dhe taksat e shtetit ndikojnë drejtpërdrejtë në performancat e përgjithshme ekonomike meqë ato përbëjnë një pjesë të madhe të aktivitetit në ekonominë kombëtare. Politika fiskale është një komponent themelore e politikës ekonomike shtetërore e cila shfytëzohet për qëllime makroekonomike si: influencimin e produktit të përgjithshëm vendorë, nivelin e punësimit, të ardhurat dhe nivelin e çmimeve. (*Dornbusch, dhe Fischer, 2000, faqe 127*).

Politika fiskale lidhet me veprimet e qeverisë në ndryshimin e kompozicionit të të hyrave dhe shpenzimeve publike, me qëllim të menaxhimit të kërkesës agregate për të mbajtur rritje të qëndrueshme ekonomike me punësim relativisht të lartë, pa gjenerim të inflacionit, pa rritje të borxhit publik dhe me bilanc të kënaqshëm të pagesave.

Varësisht nga ecuritë ekonomike, politika fiskale mund të jetë ekspansioniste (zgjeruese) dhe e shtrënguar (kufizuese). Një ekspansion fiskal do të thotë ulje e taksave ose rritje e shpenzimeve publike me qëllim të stimulimit të rritjes së konsumit, respektivisht rritjen e kërkesës agregate. Kjo ndodhë kur qeveria vërenë ngecje apo rritje të ngadalshme ekonomike ose kur papunësia është e lartë. Kështu me rritjen e shpenzimeve publike dhe shkurtimin e taksave, individëve dhe firmave u lihet një sasi më e madhe parash për ti shfytëzuar në shpenzime konsumi ose investime. Kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e punësimit dhe rritjen ekonomik.

Ndërsa, politika fiskale shtrënguese (kufizuese) do të thotë ulje e shpenzimeve publike dhe rritje e taksave. Kur qeveria synon uljen e kërkesës agregate për të ngadalësuar rritjen ekonomike apo uljen e inflacionit, përcaktohet për drejtimin e politikës fiskale shtrënguese. Nëpërmjet kësaj politike ulet oferta e parasë e cila më tutje ulë shpenzimet dhe kërkesën agregate. Njësoj ulja e ofertës së parasë bënë presion edhe në ngritjen e çmimeve të përgjithshme në ekonomi. (*Mancellari, Haderi, Kule, Qirici, 1999, faqe 396*).

Pra Politika Fiskale mund te jete:

1. Zgjeruese Aktive
2. Kufizuese Aktive
3. Zgjeruese Automatike
4. Kufizuese Automatike

	Zgjeruese	Kufizuese
Aktive	<ul style="list-style-type: none"> - Rritje e shpenzimeve qeveritare - Ulje e taksave - Ose te dyjat 	<ul style="list-style-type: none"> - Ulja e shpenzimeve qeveritare - Rritja e taksave - Ose te dyjat
Automatike	<ul style="list-style-type: none"> - Kompensim per papunesine - Asistence sociale 	<ul style="list-style-type: none"> - Kompensim per papunesine - Asistence sociale

Tabela. 1 Politikat Fiskale

Kur qeveria përcaktohet për politikën fiskale, ajo bënë paraprakisht vleresimin e një numri të madhe faktorësh përfshirë edhe ecurinë e variablave dhe indikatorëve kryesorë ekonomik dhe financiar, për shkakë të ndikimit të tyre në shumën e të hyrave të grumbulluara përmes taksave me të cilat përmbushen nevojat e financimit të programeve qeveritare.

2.1. Objektivat e Politikës Fiskale

Në procesin e formulimit të politikës fiskale, politikëbërësit përcaktojnë objektivat të cilat synojnë ti realizojnë dhe instrumentet me të cilat ato objektiva bëhen të realizueshme, duke ju përmbajtur detyrimisht principeve të menaxhimit fiskal si: transparenca lidhur me objektivat, implementimi i politikës fiskale dhe publikimi i llogarive publike, stabiliteti i procesit të bërjes së politikës fiskale, efikasiteti i ndikimit të politikës fiskale në ekonomi etj.

Objektivat e politikës fiskale lidhen me rritjen e mirëqenies së përgjithshme shoqërore si qëllim parësorë i një shoqërie bashkëkohore. Objektivat e politikave fiskale ndryshojnë edhe ato mund të përfshijnë:

1. Alokimin e të hyrave publike (tatimet) - Shumë veprimtari të rëndësishme për funksionimin e shoqërisë si: edukimi, shëndetësia, siguria publike, mirëqenia sociale, mbrojtja e ambientit, investimet publike – nuk do të ishin të mundshme ose nuk do ofroheshin në nivel të mjaftueshëm pa intervenimin e shtetit. Për t'i mënjeluar këto mangësi, politika fiskale shfrytëzon të hyrat e grumbulluara në buxhet dhe ndihmon financimin e këtyre aktiviteteve.

2. Stabilitetin makroekonomik - Ekonomitë e shumë vendeve të zhvilluara shpesh janë objekt i luhatjeve të vazhdueshme. Stagnimet eventuale në ekonomi shpesh reflektohen në buxhetin familjar dhe pastaj edhe në shpenzimet e tyre për mallra dhe shërbime. Në orvatjet e saj për të eliminuar ose zbutur luhatjet e tilla, qeveria herë pas here përdorë mjete të politikave fiskale si politika tatimore dhe shpenzimet publike.

3. Nxitjen e rritjes ekonomike - Njëpërmjet ndryshimeve në tatime dhe shpenzime publike, qeveria mund të ndihmojë në stimulimin e zhvillimit ekonomik

4. Rishpërndarjen e të hyrave - Përfituesit e të hyrave të tatimeve qeveritare i përdorin tatimet e mbledhura që të sigurojnë pensionet publike, nivelin minimal të të hyrave për personat që janë të sëmurë, fizikisht të sfiduar, të vjetër, etj. Shteti i cili ofron përparësi të lartë këtyre synimeve zakonisht preferon të përdorë sistem progresiv të të hyrave tatimore, d.m.th. se tatimohen me tepër ata të cilët kanë të ardhura më të larta (*Murray, 2001. faqe 138*).

Kjo mirëqenie sigurohet vetem në kushtet e një ambienti që e cilësojnë stabilitetin ekonomik, politik dhe social. Pra kur flasim për objektivat e politikës fiskale kemi parasysh:

- përmbushjen e nevojave publike përmes një sistemi të shëndoshë të financimit publik
- realizimin e punësimit të plotë
- rritjen e normës së shtimit ekonomik
- ruajtjen e stabilitetit të çmimeve
- stabilitetin e bilancit të pagesave
- stimulimin e investimeve
- rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore
- rritjen e cilësisë së shërbimeve në arsim dhe shëndetësi.

Realizimi i këtyre objektivave varet nga: aftësia e qeverisë për bashkërenditjen e tyre me instrumentet fiskale për të influencuar kompozicionin dhe nivelin e kërkesës agregate, saktësia e analizave makroekonomike lidhur me trendët e indikatorëve kryesorë ekonomik

dhe financiar, rregullimi dhe marrëveshjet institucionale për koordinimin e politikave makroekonomike (Murray, 2001. faqe 147)

2.1.1 Instrumentet dhe efektet e Politikës Fiskale

Përmes politikës fiskale, shteti mund të ndikoj drejtpërdrejtë në ekonomi. Kur ai vendos për taksat që i grumbullon, transferet, të mirat dhe shërbimet që i blen, financimin deficituar, në fakt angazhohet në politikën fiskale. Çfarëdo ndryshimi në nivelin e këtyre instrumenteve ka efekte të drejtpërdrejta në rrjedhat e përgjithshme ekonomike.

Përmes instrumenteve të politikës fiskale ndikohet në punësim dhe nivel të çmimeve, në rishpërndarjen më të mirë të të ardhurës dhe pasurisë, në rritjen ekonomik, në rritjen e kursimit, në nivelin e investimeve, në çështjet e edukimit, arsimit, kulturës dhe shëndetësisë (Limani, 2008, faqe135).

Per te realizuar objektivat e politikës fiskale, qeveria e ka te nevojshme të ndërhyjë drejtpërdrejt me instrumentet e kësaj politike dhe si më kryesoret janë:

1. Veprimi i Politikës Fiskale në rritjen ekonomike

Masat e politikës fiskale mund të orientohen në përballimin e vështirësive afatshkurtra të nxitura nga rrjedhat e dëmshme në ekonomi dhe përmirësimin e tyre, respektivisht eliminimin e shkaktarëve të atyre rrjedhave dhe vendosjen e stabilitetit me masat e politikës stabilizuese. Përveç në rrjedhat afatshkurtra, politika fiskale mund të orientohet edhe në rritjen afatgjate të Bruto Produktit Vendor, respektivisht të ardhurës për banor. Në këtë rast bëhet fjalë për normën e rritjes ekonomike.

Rritja ekonomike matet kryesisht me rritjen e Bruto Produktit Vendor brenda një periudhe të caktuar. Kjo rritje do të thotë njëkohësisht rritje e shpenzimeve dhe të ardhurave publike, përmirësim i kushteve jetësore dhe ngritje e standardit të jetës.

Me masat e politikës ekonomike dhe të politikës fiskale tentohet arritja e një norme optimale e matur e rritjes ekonomike e jo ajo maksimale. Norma maksimale arrihet me punësim të plotë të të gjithë faktorëve të prodhimit. Por kjo do të ishte e pamundur në praktikë. Me rastin e hartimit dhe formulimit të politikës fiskale duhet marrë parasysh edhe faktorë tjerë si ruajtja e ambientit jetësor. Prandaj, nuk mund të bëhet fjalë për një punësim të plotë të të gjithë faktorëve të prodhimit në kushte ideale.

Norma optimale e rritjes ekonomike do të thotë shfrytëzim i faktorëve të prodhimit duke marrë parasysh edhe faktorë tjerë me ndikim në interesat e përgjithshme shoqërore.

Meqë Bruto Produkti Vendor rritet me rritjen e angazhimit të faktorëve të prodhimit dhe me shfrytëzim më të mirë të tyre, atëherë ndër masat e politikës fiskale në drejtim të nxitjes së rritjes ekonomike mund të numërohen ato që kanë ndikim në rritjen e produktivitetit të punës dhe shfrytëzimin më të mirë të kapitalit, në përparimin teknologjik dhe shfrytëzimin më të mirë të faktorëve të prodhimit, si:

- stimulimi i investimeve përmes lehtësive tatimore
- subvencionimi i sektorëve të ndryshëm ekonomik
- rritja e investimeve të infrastrukturës
- nxitja dhe rritja e investimeve në kërkime, edukim dhe trajnim

Debatet publike lidhur me rritjen ekonomike përqëndrohen kryesisht në masat të cilat nxisin investimet, uljen e deficitit buxhetor për të rritur kursimet në vend, rritjen e shpenzimeve publike në edukim dhe reformimin e rregullimit shtetëror duke përfshirë rregullimin lidhur me mbrojtjen e ambientit për shkak të kostos së lartë krahasuar me dobishmërinë (*Spilimbergo, 2008*).

2. Veprimi i Politikës Fiskale në punësim dhe në nivelin e çmimeve

Shteti dhe organet tjera publike - juridike disponojnë me një pjesë të rëndësishme të të ardhurave kombëtare. Ato paraqiten në anën e kërkesës në treg dhe drejtpërdrejtë blejnë mallra dhe paguajnë për shërbimet që i shfrytëzojnë, njësoj si dhe subjektet jopublike. Nga të ardhurat publike shteti paguan pensionet, kompensimet në kohën e papunësisë, dhe ndihma të tjera sociale me të cilat ndikon në rritjen e fuqisë blerëse të atyre që i shfrytëzojnë këto pagesa. Kështu, shteti ndikon edhe indirekt në rritjen e kërkesës në treg. Mirëpo, në rritjen e kërkesës ndikon edhe ulja e ngarkesës tatimore të tatimpaguesve, lehtësitë dhe përjashtimet tatimore. Me uljen e ngarkesës tatimore rritet fuqia blerëse e tatimpaguesve që për rezultat ka rritjen e kërkesës agregate.

Në kushtet e punësimit të plotë, rritja e kërkesës agregate nuk ndikon në rritjen e prodhimit dhe numrit të të punësuarve. Në këtë rast, rritja e kërkesës do të rezultonte me rritjen e nivelit të çmimeve. Për të penguar rritjen e nivelit të çmimeve duhet të zvogëlohet kërkesa deri në nivelin e duhur (të ofertës). Kërkesa agregate zvogëlohet me reduktimin e transfertave publike, zvogëlimin e aktiviteteve publike, rritjen e ngarkesës tatimore dhe heqjen e lehtësive dhe përjashtimeve nga tatimi. Të gjitha këto masa që ndërmerren me qëllim të zvogëlimin të shpenzimeve publike dhe rritjes së të ardhurave publike janë të njohura si masa të politikës restriktive apo kontraktive fiskale (*Sinai, 2009*).

Nëse kërkesa agregate është më e vogël se oferta, prapë vjen deri te ndryshimi i nivelit të çmimeve, që d.m.th. çmimet ulen. Për të vendosur baraspeshën, shteti duhet t'i orientojë politikat fiskale në rritjen e kërkesës agregate përmes rritjes së shpenzimeve dhe uljes së të ardhurave publike. Në radhët e shpenzimeve shteti rrit dhënie sociale, hap vende të reja pune, rrit aktivitetin investues dhe zvogëlon barrën tatimore. Këto masa ndikojnë në rritjen e fuqisë blerëse të qytetarëve e me këtë edhe në rritjen e kërkesës së përgjithshme dhe njihen si masa të politikës ekspansive fiskale.

Ndërsa, masat neutrale të politikës fiskale kanë për qëllim të ruajnë punësimin e plotë dhe nivelin e duhur të çmimeve. Në këtë rast, shpenzimet publike duhet të caktohen në atë mënyrë që kërkesa të mbetet e pandryshuar.

Hendeku i ekspansionit- i cili shkaktohet nga rritja e tepërt e kërkesës agregate, mbyllet me politikë fiskale shtrënguese duke shkurtuar shpenzimet publike për të ndikuar në rënien e kërkesës agregate e cila më tutje ndikon në rënien e BPV dhe uljen e nivelit të çmimeve

Hendeku i recesionit - i cili shkaktohet nga kërkesa e pamjaftueshme, mbyllet me ekspansion fiskal i cili drejtpërdrejtë rrit kërkesën agregate dhe BPV deri në nivelin e punësimit të plotë (produktit potencial).

3. Ndikimi i Multiplikatorit dhe Akseleratorit në implementimin e Politikës Fiskale

Në procesin e implementimit të politikës ekspansive dhe restriktive fiskale, gjithnjë duhet pasur parasysh veprimin e multiplikatorit dhe akseleratorit.

Multiplikatori i shpenzimeve publike tregon sa herë rriten (zvogëlohen) të ardhurat kur rriten (zvogëlohen) shpenzimet publike. Kështu, në përpjekjet për uljen e papunësisë dhe rritjen e kërkesës së përgjithshme, shteti organizon punë publike në përmasa të gjëra. Me hapjen e vendeve të reja të punës dhe me realizimin e të ardhurave të të punësuarve në këtë sektor, rritet kërkesa për produkte dhe shërbime në treg.

Rritja e kërkesës ndikon në rritjen e prodhimit, e kjo d.m.th. angazhim i fuqisë së re punëtore, të cilët me të ardhurat e realizuara prapë paraqiten në treg, e kështu me radhë.

Në këtë rast bëhet fjalë për multiplikatorin me parashenjë pozitive. Në të kundërtën, nëse me masat e politikës fiskale synohet ulja e kërkesës, atëherë rritet ngarkesa tatimore e cila ndikon në zvogëlimin e fuqisë blerëse, e kjo shkakton zvogëlimin e kërkesës që ka për pasojë zvogëlimin e prodhimit. Zvogëlimi i prodhimit automatikisht ndikon në zvogëlimin e numrit të të punësuarve e kjo prapë zvogëlon kërkesën. Ky proces do të përsëritet derisa nuk dobësohen efektet e rritjes së ngarkesës tatimore. Në këtë rast kemi të bëjmë me multiplikatorin me parashenjë negative (*Dornbusch, Fisher, 2000, faqe 113*).

Akseleratori tregon raportin midis vlerës së investimeve neto dhe rritjes së kërkesës. Me ndihmën e shpenzimeve publike plotësuese, si p.sh. dhënia e kredive me kushte të mira, dhënia e subvencioneve, marrja e garancive, shteti ndikon në përshtetimin e aktivitetit të subjekteve ekonomike me qëllim të vënies së baraspeshës parciale. Ky veprim në praktikë njihet si veprim i akseleratorit, veprim induktiv i shpenzimeve publike apo ndikim terciar i shpenzimeve publike.

Shteti ndikon në rritjen apo zvogëlimin e nivelit të punësimit duke bërë alokacionin e investimeve në veprimtari intensive, duke ofruar lehtësi tatimore ndërmarrjeve të cilat angazhojnë fuqi punëtore shtesë, duke zvogëluar barrën tatimore personave që merren me veprimtari prodhuese dhe shërbuese, e tjerë (*Dornbusch, Fisher, 2000, faqe 113*).

4. Veprimi i Politikës Fiskale në rishpërndarjen e të ardhurës dhe pasurisë

Përmes politikës fiskale ndikohet në vendosjen e raporteve të dëshiruara në fuqinë ekonomike të qytetarëve. Duhet theksuar se këtu shteti nuk ka për qëllim të ndikojë në barabarësinë e qytetarëve sa i përket fuqisë ekonomike, sepse kjo mund të ketë pasojë në humbjen e motivimit që me punë më të mirë e me përpjekje më të mëdha dhe me përgjegjësi të madhe në vendin e punës, të realizohen të ardhura më të larta respektivisht pasuri. Nga ky këndvështrim varen edhe masat të cilat duhet ndërmarrë për vendosjen e raporteve të caktuara në të ardhurat dhe pasurinë.

Dallimi në lartësinë e të ardhurave mund të zvogëlohet përmes:

- Aplikimit të normave tatimore progresive në të ardhurat
- Lehtësive dhe përjashtimeve nga barra tatimore e tatimpaguesve me të ardhura të ulëta
- Aplikimit të tatimit diferencial në një pjesë të të ardhurave, ashtu që tatimpaguesit me të ardhura më të larta të ngarkohen me një përqindje më të madhe të tatimit.

Në rishpërndarjen e të ardhurave ndikohet edhe përmes shpenzimeve publike si instrument i politikës fiskale përmes formave të cilat shtojnë përkujdesjen më të madhe ndaj kategorive me të ardhura të ulëta. Me rastin e vlerësimit të masave, gjithëherë duhet marrë parasysh ndikimi i tatimeve indirekte. Veprimet apo efektet regresive të këtyre tatimeve janë

më të mëdha sa më i madh të jetë numri i produkteve dhe shërbimeve të tatuara, sa më e madhe të jetë ngarkesa tatimore dhe sa më i vogël të jetë seleksionimi i produkteve dhe shërbimeve në qarkullim.

Në shpërndarjen më të drejtë të pasurisë ndikohet përmes këtyre masave të politikës fiskale:

- aplikimi i tatimeve në trashëgimi dhe dhurata si dhe tatimi real në pasuri
- ofrimi i çmimeve më të ulëta të materialit ndërtimor për kategorinë me të ardhura të ulta
- lirimi i përkohshëm nga tatimi
- shitja e parcelave tokësore që janë pronë e shtetit me kushte të volitshme
- dhe masa që ndikojnë në rritjen e kursimit

5. Projektet publike të punësimit

Ndryshe nga projektet publike të investimeve që kerkojnë shumë kapital dhe kohë të gjatë për tu realizuar, projektet publike të punësimit synojnë zënieën me punë të punëtorëve në periudha deri në një vit.

Këto projekte përfaqësojnë një mjet stabilizimi që është përdorur më shpesh kohët e fundit, edhe ndaj këtij mjeti ka mjaft kritika që lidhen me eficienten e tyre dhe me faktin që ato nuk ofrojnë punëzënie serioze të të papunëve.

6. Ndryshimi i normave të taksave

Ndryshimi i normave të taksave në drejtimin e duhur mund të përdoret për të stimuluar apo frenuar zhvillimin e ekonomisë. Sidoqoftë, mendohet se ky mjet mund të përdoret me sukses vetëm në qoft se do të mund arrihej një ndryshim i shpejtë dhe i përkohshëm i taksave, sepse në të kundërtën do të kalonte faza përkatëse e ciklit dhe ndryshimi i taksave në vend që të sillte dobi do të sillte dëme. Por, nga njëra anë është e vështirë të arrihet një ndryshim i shpejt dhe i përkohshëm i taksave (sepse kur një taksë ulet politikisht është e vështirë rritja e saj përsëri). Nga ana tjetër, njerëzit duke qenë të ndërgjegjshëm për karakterin e përkohshëm të ndryshimit të taksave, nuk do të ndryshojnë në mënyrë të mjaftueshme sjelljen e tyre (masën e konsumit), duke kushtëzuar kështu efekte të kufizuara kundërciklike të politikës fiskale.

Zbatimi i një politike të caktuar fiskale do të ketë ndikimin e vet në buxhetin e qeverisë, përkatësisht në zërat e shpenzimeve apo të të ardhurave dhe për rrjedhojë edhe në gjendjen e buxhetit, si buxhet suficitar, deficitar apo i balancuar.²

²Mancelleri, A. Haderi, S. Kule, Dh. Dhe Qirici, S. (1999). Hyrje në Ekonomi, Pegi, 1999, Tirane

7. Projektet e investimeve publike

Projekte të tilla si ai i elektrifikimit, të furnizimit me ujë etj. Sidoqoft, sot projekte të tilla relativisht afatgjata që kanë nevojë për një kohë më të gjatë që të vihen në jetë përdoren rralë. Efektet e tyre kunderciklike mund të jenë negative, sepse ato mund të fillojnë kur faza përkatëse e ciklit të biznesit të ketë kaluar.

8. Efekte tjera të aplikimit të instrumenteve të Politikës Fiskale

Instrumentet e politikës fiskale mund të aplikohen edhe për qëllime tjera si në fushën e politikës së edukimit, arsimimit, për qëllime demografike, kulturore, ndërtimore, shëndetësore dhe komerciale. Shteti paraqitet si punëdhënës në ndërmarrjet publike, në administratën publike, në organet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë. Përmes politikës doganore, shteti rrit eksportin dhe zvogëlon importin, e me këtë zvogëlon deficitin në bilancin e pagesave dhe përmirëson vlerën e valutës kombëtare. Me politikën fiskale ndikohet edhe në zhvillimin regjional dhe në përmirësimin e strukturës ekonomike (*Gregory, 2003*).

2.1.2. Ekonomia e tregut dhe nderhyrja e shtetit në rregullimin e Politikës Fiskale

Në kushtet e ekonomisë së hapur ndaj rrjedhave të kapitalit, menaxhmenti i politikës fiskale bëhet më i vështirë. Vendet që i nënshtrohen procesit të globalizimit ballafaqohen me pasiguri të shumta që lidhen me madhësinë, shpejtësinë dhe kohën e mundshme të rrjedhave të kapitalit. Masa e efekteve negative në rrjedhat ekonomike të vendit varet nga madhësia e ekonomisë dhe roli që u është dhënë instrumenteve të politikave makroekonomike për kontrollimin e kapitalit.

Pasiguritë më të mëdha lidhen me faktorët ekzogjen mbi të cilët shumica e vendeve ka pak ose aspak kontroll. Ndryshimet e zhvillimeve në ekonomitë industriale si norma e interesit dhe shtimi ekonomik kanë rëndësi të madhe për ekonomitë më të vogla meqë mund të ndikojnë në zhvendosjen e investimeve. Kjo parashton kërkesa për formulimin e politikave makroekonomike të përshtatshme dhe të qëndrueshme në afate të mesme dhe të gjata, duke përfshirë masat që reduktojnë ndikimet negative që vijnë nga faktorët ekzogjen, ose në të kundërtën të përballen me çrregullimet e rrjedhës së kapitalit.

Disa faktorë që ndikojnë lëvizjet e kapitalit janë të natyrës endogjene si rezultat i drejtpërdrejtë i politikave makroekonomike të vendit. Vetë politika fiskale ekspansioniste mund të jetë burim i problemeve në rrjedhat e kapitalit në vend e cila e shoqëruar me politika monetare shtrënguese, shpie në norma të larta të interesit, që fillimisht nxisin hyrjen e kapitalit por me probleme të theksuara të mëvonshme. Perceptimet lidhur me qëndrueshmërinë e disiplinës fiskale janë faktorë i rëndësishëm për influencimin e pritjeve investuese por edhe burim potencial i jostabilitetit në rrjedhat e kapitalit (*Minxhozi, 2007, faqe 129*).

Rrjedhat e kapitalit lidhen ngushtë edhe me lëvizjet ciklike në ekonomi, të cilat mund të përkeqësojnë pozicionin fiskal. Kështu, nën presionin e derdhjes së kapitalit në periudhat e

recesionit, për politikbërësit do të jetë më e vështirë që përmes politikës fiskale shtrënguese të ndikojnë në rrjedha të kundërta në bilancin e pagesave, veçmas në kushtet kur instrumentet tjera të politikave makroekonomike janë të kufizuara.

Për uljen e presioneve në tregun financiar të vendit, mbajtjen e produktit në nivelin potencial dhe kufizimin e shkurtimeve private (crowding-out), konsolidimet fiskale të përshtatura në formë prociklike dhe të mbështetura me masa kompensuese monetare bëhen të domosdoshme. Konsolidimet janë të efektshme deri në masën në të cilën ato u qëndrojnë ndryshimeve në zhvillimet ekonomike të nxitura nga rrjedhat e kapitalit dhe shkalla e parashikimit të natyrës, masës dhe drejtimit të këtyre rrjedhave.

Komponentët e politikës fiskale, taksat dhe programet e shpenzimeve publike, u shërbejnë qëllimeve të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore të cilat mund të vihen në rrezik po qe se janë të nevojshme përshtatjet kuantitativisht të gjera për afate të shkurtra. Me disa variabla fiskale është vështirë të manipulohet në mënyrë fleksibile për periudha afatshkurtra, meqë kjo mund të rezultojë me kosto të lartë të transaksionit dhe krijon shtrembërime në alokacionin dhe rishpërndarjen e resurseve. Nëse vlerësimet shpiejnë në përfundim se reagimi fiskal është i pashmangshëm, atëherë duhet vënë në përdorim komponentët e politikës fiskale, të cilat mendohen të jenë më fleksibile, më efektive, dhe krijojnë më pak shtrembërime se të tjerat.

Në këto kushte, rëndësi të veçantë ka identifikimi dhe ndarja e funksioneve bërthamore në strukturën fiskale, proces i cili vështirësohet nga fakti i definimit të kësaj "bërthame". Veçimi i këtyre funksioneve dallon ndërmjet vendeve të ndryshme varësisht nga ajo se çka mendohet si e nevojshme dhe e domosdoshme në aspektin shoqëror. Ky definim nuk duhet të merret si i përhershëm përderisa qeveria mund të bëjë korrigjime të kohëpaskohshme për të vlerësuar koston eventuale të përshtatjeve të pranueshme në strukturën fiskale. Veçimi i funksioneve bërthamore lehtëson në masë të madhe zgjedhjen dhe përdorimin e atyre instrumenteve që më së paku do të prekin bërthamën e strukturës fiskale si përgjigje ndaj rrjedhave të kapitalit (*Dornbusch, Fischer, 2000, faqe 216*).

E gjithë kjo na shpie në përfundim se hapja ndaj rrjedhave të kapitalit kushtëzohet paraprakisht me ndërtimin e një disipline të brendshme për drejtimin e politikës fiskale. Kjo disiplinë sigurohet me vënien e rregullave të cilat mbështeten në principet e politikës fiskale dhe ndikon në formimin e pritjeve stabile në treg, në mënyrë që lëkundjet dhe shtrëngimet potenciale fiskale shihen si të pranueshme dhe konsistente me rregullat e ndërtuara për menaxhim të një politike të matur fiskale.

Roli i qeverisë në përcaktimin e politikës fiskale e cila qon në ekspansion apo shtrëngim të ecurisë ekonomike ndihmohet përmes mekanizmave të krijuara, të cilat janë:

- Tatimet e drejtpërdrejta- Në këtë grup tatimesh përfshihen tatimet në te hyra personale, tatimet në të hyrat e korporatave, apo dhe tatimet në prone.
- Tatimet indirekte- përfshijnë në mes të tjerash TVSH-në, akcizën dhe tarifat doganore. Momentalisht, tatimet indirekte kontribuojnë me përqindjen më të madhe të të hyrave të grumbulluara. Këto lloje të të hyrave më së shumti mblidhen në pikat doganore.
- Taksat- mund të aplikohen tek shërbimet lokale ose në nivel kombëtar.

Shembuj të shërbimeve të cilat mund t'i nënshtrohen taksave janë: aeroporti, disa dokumente të lëshuara nga administrata publike, regjistrimi i bizneseve etj. Është si rregull, që këto lloje të të hyrave nuk luajnë rol të rëndësishëm në buxhetin e një vendi.

- Huazimet publike- Në situata ku qeveria nuk ka mundësi të financojë shpenzimet aktuale publike përmes mbledhjes së tatimeve të rregullta, ajo detyrohet të huazojë nga burime të brendshme ose të jashtme.

Tradicionalisht, qeveritë kanë ndikuar në rolin e shpërndarjes së këtyre të mirave publike, që të përcaktojnë vlerën optimale të të mirave publike që shpërndahen optimalisht dhe të jenë në gjendje të mbledhin fonde për të financuar atë.

Llojet e të mirave që qeveria shpërndan, janë të mirat publike. Një produkt ose shërbim është publik, nëse karakterizohet si e mirë e të gjithëve.

Është shumë me rëndësi të provohet që alokimi i të mirave të bartet nga një grup i shoqërisë tek një tjetër. Politika e Evropës Perëndimore shpesh tenton të shpërndajë resurset te njerëzit që jetojnë në varfëri prej atyre që u takojnë të pasurve.

John Keynes, një ekonomist i dëshmuar, formuloi teorinë e tij gjatë "Depresionit të Madh", kur qeveritë në Evropë dhe në Amerikën Veriore luftuan të ringjallin ekonominë e tronditura nga pengesat e efekteve negative nga zhvlerësimet enorme të valutave shtetërore.

Të gjitha paratë që qeveria shpenzon kanë një efekt stimulues në ekonominë e një vendi. Qeveria ka kapacitet të tillë, që mund të ndikojnë me shpenzimet e saja në ekonominë e vendit. Shkolla e mendimit, sipas të cilës qeveria luan një rol aktiv në stimulimin e rritjes ekonomike gjatë periudhave recesioniste dhe në uljen e shpenzimeve në gjendjen tjetër, quhet Shkolla Kejnside, e themeluar nga ekonomisti John Keynes. Problemi me këtë shkollë të mendimit është se kur tezat e saj aplikohen, ajo apelon që në gjendje të depresionit, qeveria duhet të shpenzojë para dhe të ndihmojë njerëzit kur kanë nevojë.

Ekzistojnë dy lloje të shpenzimeve: shpenzimi i parasë në blerjen e mallrave dhe shërbimeve dhe transferin e fondeve te nivelet e tjera të qeverisjes.

Në një sistem federal, të dy qeveritë, ajo federale dhe provinciale drejtojnë politikën fiskale. Kushtetuta përcakton zonat e përgjegjësisë për të dy nivelet e qeverisjes.

Mbretëria e bashkuar është një shembull i një sistemi unitar, në të cilin ekziston një qeveri qendrore pa qeveri provinciale.

Kanada është një shembull i shkëlqyer i sistemit federal qeveritar, ku ekziston një qeveri federale dhe dhjetë qeveri provinciale. Nën qeveritë provinciale, ekzistojnë një mori të qeverive lokale.

Ekzistojnë dy metoda të financimit: Venia e taksave dhe kursimi.

Taksat kanë një vend të rëndësishëm në shtetet e zhvilluara përfshirë taksat mbi personin dhe taksat mbi të hyrat e korporatave, të quajtura tatimi mbi vlerën e shtuar dhe mbledhja e taskave në lloje specifike të mallrave. Detyrimet e marra nga qeveria janë një

variabël shumë e rëndësishme dhe një komponent e cila ndikon në administrimin e politikës fiskale. Në shoqëritë demokratike, qeveria vepron në shumë mënyra të ndryshme.

Qeveria do të ketë qëllime të ndryshme, të cilat do t'i arrijë me anë të politikës fiskale. Ajo mund të zbut të ardhurat kombëtare, me qëllim të minimizimit të efekteve tek ciklet e zhvillimit të bizneseve, apo mund të ketë ndikimin e saj në rritjen e të ardhurave kombëtare. Qeveria gjithashtu, mund të ketë ndërmarrur hapa për të arritur objektiva të veqanta sociale të bazuara në politika të përcaktuara fiskale.

2.1.3 Sfidat e Politikës Fiskale në Kosovë

Sot kur nga fillimi i procesit të tranzicionit në shtetet ballkanike kanë kaluar rreth 19 vjet. Reformimi i sistemeve të tyre tatimore ende është në vazhdim duke u ballafaquar me sfida të shumta. Reformimi i sistemeve tatimore është njëri nga segmentet më të rëndësishme të tranzicionit të tyre shoqëror-ekonomik të udhëhequr nga aspirimi për t'u anëtarësuar në Unionin Evropian. Rezultatet më të mëdha konsistojnë në atë se të gjitha shtetet ballkanike, kush më e herët e kush më vonë, kanë aplikuar në sistemet e tyre tatimore tatimin në të ardhurat personale, tatimin në të ardhura të korporatave dhe TVSH-në. Në këtë kuadër, me qëllim të krijimit të sistemeve tatimore konkurruese për joshje të investimeve dhe harmonizimit tatimor me UE-në janë ulur dukshëm normat tatimore dhe janë ndërmarrë hapa të suksesshëm në funksion të harmonizimit të tatimeve me shtetet anëtare të Unionit Evropian. Disa shtete kanë arritur që sistemet e tyre tatimore t'i ndërtojnë në përputhje kerkesat e kohës.

Krijimi i sistemit dhe politikës tatimore në Kosovë nga ana e UNMIK-ut është rast i shembullit unik të krijuar në praktikë pa ndikimin e brendshëm dhe pa dialog politik. Nga 1999 e deri me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, UNMIK-u ishte kreator i sistemit dhe politikës tatimore në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndërmori hapin e parë reformues duke ulur normat tatimore të tatimit në të ardhura personale dhe tatimit në të ardhura të korporatave. Megjithatë, sistemi dhe politika tatimore në Kosovë duhet reformuar edhe në shumë segmente të tjera

Kosova është një ekonomi e vogël dhe e hapur, disa nga tiparet e spikatura të së cilës janë kapaciteti i ulët i prodhimit vendor, e karakterizuar nga baza e ulët e eksporteve, deficitit shumë i lartë tregtar, dhe nga një nivel i ulët i efikasitetit vendor dhe konkurrueshmërisë. Kjo veçanti strukturore gjeneron një nivel të lartë të varësisë nga importet, që shpie në një kapacitet të lartë absorbues dhe në një mbështetje të konsiderueshme korresponduese në remitencat dhe në financimin nga donatorët, për financim të deficitit tregtar. Marrë parasysh faktin që operon në një regjim të bazuar në euro, kundrejt një sfondi të tillë të çekuilibrave makroekonomik, Kosova varet nga përshtatjet e shkallës reale të këmbimit për të përmirësuar konkurrueshmërinë e saj. Kjo hapësirë e sforcuar për fleksibilitet të politikave nënkupton që

Kosova duhet të mbështetet në përshtatjet e pagave reale për të përmirësuar efikasitetin e brendshëm, dhe për të gjeneruar produktivitet dhe konkurrueshmëri më të lartë. Si rezultat, projektionet makro-fiskale për periudhën afatmesme janë të bazuara në supozimet për reduktime të lehta në koston relative në lidhje me prodhimin vendor. Kjo strukturë e ekonomisë parashihet të vazhdojë në këtë mënyrë gjatë një periudhe të caktuar kohore në të ardhmen.

Veçoria e parë dhe më interesante për ekonominë e Kosovës është se shpenzon ose absorbon në total rreth 33% më shumë sesa BPV-ja që e prodhon. Ky deficit tregtar i llogarisë së jashtme kryesisht financohet nga rrjedhat hyrëse të donatorëve dhe transfereve, shumica e të cilave janë në formë të dërgesave private/remitansat.

Rritja e eksporteve dhe zëvendësimi i importeve mund të ndodh vetëm nëse ka ndryshim në çmimet relative, me fjalë të tjera, kosto më të ulëta të prodhimit në Kosovë në relacion me çmimet e importit. Duke pasur parasysh që Kosova përdor euron, ajo nuk mund të kontrollojë (në këtë rast të zhvlerësojë (devalvoj)) shkallën e saj nominale të këmbimit. Prandaj, rruga e vetme për përshtatjen e çmimeve relative është mbajtja e shkallës së inflacionit të koston vendore në nivelin e çmimeve në tregun ndërkombëtar në euro, që do të shtrijë nevojën për përmbytje në rroga si dhe rritje të produktivitetit.

Kosova ka ndërtuar një politikë të shëndoshë fiskale përmes së cilës është tentuar të ndikohet në stimulimin e rritjes ekonomike si dhe krijimin e stabilitetit të përgjithshëm fiskal. Kjo politikë ka bërë që deri më tani të sigurohet një qëndrueshmëri financiare si rezultat i gjenerimit të konsiderueshëm të të hyrave, përderisa nga aspekti i shpenzimeve në vazhdimësi është arritur përmirësimi dhe rritja e shkallës së ekzekutimit të shpenzimeve. Të hyrat e mbledhura edhe më tutje nuk reflektojnë një ngarkesë të madhe për ekonominë, pasi që ato edhe më tutje sillen në nivelin prej 23% të BPV-së. Rritja e shpenzimeve kapitale ka bërë që gjatë vitit të kaluar burim i rëndësishëm i rritjes ekonomike të jenë investimet publike.

Ruajtja e qëndrueshmërisë buxhetore dhe fiskale është dhe mbetet synimi kryesor në këtë sektor. Ndryshimi i normave tatimore të miratuara gjatë vitit të kaluar kanë pasur për synim këtë aspekt. Qe nga 1 Janar 2009 Kosova ka filluar aplikimin e paketës së ndryshimeve në normat tatimore të cilat parashohin zvogëlimin e normës së tatimit në korporata nga 20% në 10% si dhe ndryshimin e normës progresive të tatimit në të ardhurat personale nga 0,5,10 dhe 20% në 0,4,8, dhe 10%. Në të njëjtën kohë me qëllim të kompensimit të humbjeve nga ulja e këtyre normave është aprovuar edhe rritja e normës së TVSH-së nga 15% sa ka qenë më parë në 16%, si dhe ngritja e normës së akcizës në importin e duhanit nga 17 në 21€ për njësi. Te hyrat e gjeneruara gjatë kësaj periudhe kanë qenë më të larta sesa shpenzimet, çka ka ndikuar që bilanci primar të jetë pozitiv.

Mbledhja e të hyrave buxhetore kryesisht realizohet përmes dy institucioneve kryesore: Administratës Tatimore të Kosovës si dhe Shërbimit Doganor të Kosovës. Gjatë gjithë periudhës këto institucione kanë shënuar rezultate të kënaqshme në mbledhjen e të hyrave tatimore, si dhe në uljen e nivelit të evazionit fiskal.

Struktura aktuale e ekonomisë flet për një varësi të madhe të ekonomisë nga importi. Fakti që pjesa më e madhe e tatimeve indirekte mblidhen në kufi ka ndikuar që kjo kategori e të hyrave edhe më tutje të jetë mjaft e lartë krahasuar me të hyrat e mbledhura brenda në vend. Të hyrat që mblidhen në kufi përbënin rreth 64% e gjithë të hyrave të mbledhura në

këtë periudhë, shkallë kjo që duket të jetë e njëjtë krahasuar me vitin e kaluar. Përpos të hyrave tatimore, një rol të veçantë kanë edhe të hyrat jo-tatimore të cilat kanë pasur një pjesëmarrje prej rreth 15% në totalin e të hyrave, pjesëmarrje kjo që krahasuar me vitin e kaluar duket të jetë pothuajse e njëjtë.

Për shkak se Kosova është ekonomi e hapur me varësi të madhe nga importet, kushtet në ekonominë globale kanë ndikim të madh në krijimin e të hyrave brenda Kosovës. Për shembull, inflacioni i madh i çmimeve të ndërlidhura me naftë dhe çmime të produkteve bujqësore kanë bërë që të hyrat të jenë më të larta se sa që është pritur. Pasi që inflacioni në Kosovë të zvogëlohet, që në masë të madhe varet nga çmimet e importit, gjithashtu do të ndikoj në nivelin e gjenerimit të të hyrave. Kjo nënkupton se performansa e mirë në gjenerimin e të hyrave vitin e kaluar pjesërisht ka ndodhur për shkak të kushteve që kanë qenë në ekonominë botërore, e jo në masë të madhe nga përmirësimet e dukshme në mbledhjen e të hyrave më të mëdha.

Të hyrat tatimore nga kufiri -Tatimet e mbledhura në kufi vazhdojnë të mbesin gjeneruesit kryesor të të hyrave buxhetore të Kosovës. Kjo kategori e të hyrave ka pasur një pjesëmarrje prej 64% në totalin e të hyrave. Ndryshimet në normat tatimore kanë pasur një ndikim të veçantë në mbledhjen e të hyrave në kufi. Ngritja e normës së TVSH-së për një përqind ka ndikuar pozitivisht në nivelin e të hyrave të gjeneruara, përderisa të hyrat nga akciza, e më saktësisht të hyrat nga akciza në duhan, kanë qenë dukshëm më ulëta si rezultat i rritjes së importit në fund të vitit të kaluar me qëllim evitimin e normave të reja në këtë produkt. Kjo rritje e importit të duhanit në fund të vitit 2008 ka rezultuar me krijimin e rezervave të mëdha të duhanit që si pasojë ka pasur uljen e importit të duhanit gjatë periudhës Janar – Qershor 2009.

Taksat doganore – Të hyrat nga kjo taksë gjatë kësaj periudhe kanë arritur shumën prej €39.8 milion, duke treguar një performancë të kënaqshme, dhe afërsisht një nivel të njëjtë me të hyrat gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Ky nivel i të hyrave është mjaft inkurajues kur kemi parasysh faktin që rënia e çmimeve në tregun ndërkombëtar ka pasur ndikim të madh në uljen e bazës doganore të mallrave të cilat importohen, dhe si rezultat i kësaj edhe në të hyrat nga taksa doganore. Një përmirësim i dukshëm i efikasitetit të Doganave të Kosovës në kontrollin më të mirë të qarkullimit të mallrave ka ndikuar që edhe përkundër uljes së çmimeve në tregun global të hyrat të jenë në nivelin e pritur. Gjithashtu duhet cekur që pas futjes së kontrollit në dy pikat doganore në veri të Kosovës të cilat janë duke bërë evidentimin e mallrave të cilat kalojnë kufirin, një pjesë e konsiderueshme e shmangieve janë reduktuar.

Taksa e akcizës – Ky është një tatim specifik i cili mbledhet në mallrat e luksit (derivate në naftës, duhan, pije alkoolike etj.). Mbledhja e tatimit në akcizë ishte më e ulët se sa në periudhën e vitit të kaluar për rreth 13%

TVSH në kufi – të hyrat e mbledhura nga ky tatim gjatë kësaj periudhe kanë qenë në vlerë prej €126.1 milion, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë për afër 4.2% më të ulëta. Kjo rënie në nivelin e të hyrave ka ardhur kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve në tregun ndërkombëtar që si pasojë ka pasur uljen e bazës doganore të mallrave të importuar që nënkupton edhe të hyra më të vogla.

Edhe përkundër faktit që norma e TVSH-së është ngritur nga 15 në 16%, fillimi i këtij viti, nuk ka mundur të kompensoj humbjet e shkaktuara nga rënia e çmimeve në tregun global. Rënia në nivelin e mbledhjes së TVSH-së është më e theksuar në tremujorin e parë të këtij viti, ndërsa që tremujori i dytë tregon një ngritje në nivelin e të hyrave nga ky tatim. Edhe përkundër kësaj rënie në këtë fazë të vitit trendi aktual lë të kuptojë që deri në fund të vitit do të realizohen parashikimet e bëra në fillim të vitit.

Tatimet e mbledhura brenda në vend – niveli i të hyrave nga kjo kategori gjatë kësaj periudhe ka qenë rreth 5% me i lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky nivel i të hyrave të mbledhura në këtë periudhë duket të jetë mjaft inkurajuese, duke pasuar parasysh faktin që ndryshimet në normat tatimore kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në zvogëlimin e obligimeve tatimore për bizneset.

Struktura e të hyrave të mbledhura brenda në vend gjatë kësaj periudhe ka pësuar ndryshime ku të hyrat nga TVSH-ja kanë shënuar një rënie në pjesëmarrje në totalin e të hyrave nga tatimet vendore.

Tatimi në të ardhurat personale – vendoset në të gjitha llojet e të hyrave, e jo vetëm në paga. Aplikohet për të hyrat nga aktivitetet e biznesit, të hyrat nga punësimi, të hyrat nga investimet, të hyrat nga pronësia intelektuale dhe industriale, të hyrat nga qiraja dhe të tjera. Të dhënat e ofruara nga ATK tregojnë se mbledhja e të hyrave gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 kanë qenë më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar për rreth 24%. Është shumë inkurajues fakti që edhe përkundër uljes së theksuar së normave të tatimit në të ardhurat personale, të hyrat e mbledhura nga ky lloj i tatimit kanë qenë më të larta gjatë kësaj periudhe krahasuar me vitin e kaluar.

Tatimi në të hyrat e korporatave – është tatim që aplikohet në të hyrat e korporatave. Kriteri për t'iu nënshtruar këtij tatimi ka të bëjë me formën ligjore të organizmit të biznesit e jo me qarkullimin dhe bruto shitjet, ose nga vëllimi i aseteve pasi këto kanë të bëjnë me tatimin në profit.

Të hyrat jo tatimore dhe të hyrat vetanake komunale – kanë pasur një ngritje të theksuar prej rreth 5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje e kësaj kategorie të të hyrave ka ardhur si rezultat i përmirësimit të mbledhjes së taksave dhe ngarkesave nga ana e institucioneve përgjegjëse. Vlen të ceket që në këtë periudhë të vitit të hyrat nga investimi i parasë publike në tregjet ndërkombëtare ka qenë shumë i vogël. Nga ana tjetër të hyrat nga tatimi në pronë kanë qenë në nivelin e parashikuar, mirëpo inkasimi i të hyrave nga taksat dhe tarifat tjera ka shënuar një rritje të dukshme gjë që ka bërë që të hyrat jotatimore në tërësi të kenë një performancë të kënaqshme.

Arkate Fiskale - vazhdimësi e reformave tatimore kundër ekonomisë jo-formale

Me masat më të reja të qeverisë që synojnë të rrisin kontrollin financiar ndaj bizneseve shpresohet se do t'i jepet fund ekonomisë joformale apo evazionit të ndryshëm tatimor i cili dhjetë viteve të fundit në Kosovë kishte arritur kulmin e vet. Nëse jo fund krejtësisht, atëherë të paktën synohet që ai të zvogëlohet në masë të konsiderueshme.

Pas pajisjes së tatimpaguesve me numrat fiskal dhe hyrjen në fuqi të pakos së re ligjore, ditët në vijim apo deri më 31.07.2010 bizneset do të detyrohen që pajisen edhe me arkat fiskale, projekt që siç thuhet do të implementohet gjatë vitit 2010.

Regjistruesi elektronik fiskal apo siç njihet ndryshe arka fiskale është një pajisje me memorie fiskale, në të cilat regjistrohen të dhënat për vlerën e mallrave të shitura dhe shërbimeve të kryera për klientët, duke siguruar në këtë mënyrë raportin për çdo transaksion të ndodhur brenda periudhës tatimore.

Tatimpaguesit, të cilët shesin mallra, prodhime, apo kryejnë shërbime, janë të detyruar të përdorin pajisje fiskale për të regjistruar dhe certifikuar shitjen dhe të lëshojnë, në mënyrë të detyrueshme kuponin tatimor. Regjistruesi elektronik ka si qëllim të certifikojë dhe regjistrojë shitjet duke përdorur një mekanizëm për regjistrimin e qarkullimit, i cili duhet të jetë i mbrojtur. Të dhënat duhet të regjistrohen në mënyrë të njëkohshme në një memorie që quhet memoria fiskale dhe në përfundim të çdo dite, subjekti duhet të përgatisë një raport, të cilin ia dërgon në formë elektronike autoriteteve tatimore.

Futja në përdorim e arkave fiskale është një hap shume konkret në luftë kundër ekonomisë joformale dhe dukurive negative në ekonominë e një shteti. Por duke i marrë parasysh përvojat e vendeve tjera e veçanërisht vendeve fqinje siç janë Shqipëria dhe Maqedonia projekti i arkave fiskale është duke hasur në shume pengesa dhe vështirësi dhe krejt kjo vije si pasojë e mosgatishmërisë së tatimpaguesve për pajisjen me këto arka dhe vazhdimin e punës apo ekonomisë joformale dhe mosdeklarimin korrekt të transaksioneve të ndryshme që ndodhin gjatë një periudhe tatimore.

I njëjti problem mund të na përcjell edhe ne në Kosovë në qoftë se vazhdohet me këtë trend dhe nuk ka përqëndrim që në start të projektit në evitimin e problemeve apo vështirësive që pritet të shfaqen në vazhdim.

Duke marrë parasysh se bizneset janë shumë pak të informuara rreth arkave fiskale, sipas mendimit tim Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Administrata Tatimore si ekzekutuese e këtij projekti duhet sa më shumë të organizojë trajnime nëpër regjione tatimore, të intensifikojë fushatat reklamuese e të formohet ekip i posaçëm në çdo regjion për informim të bizneseve se si do të funksionojë arka fiskale.

Aktualisht në Kosovë po hyhet në një periudhë apo pako të re ligjore dhe kjo pako e re ligjore dhe implementimi i tij nuk do ta kishte efektin e vet të plotë pa futjen në funksion të arkave fiskal, sepse janë gjëra të ndërlidhura që funksionojnë së bashku dhe kanë një rëndësi shume të madhe si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në aspektin politik.

Zbatimi i suksesshëm i këtij projekti kërkon një qasje më pragmatike dhe të barabartë për të gjitha bizneset, në të gjitha pjesët e Kosovës, për të evituar konkurrencën jo lojale për të cilën ankohen një pjesë e madhe e bizneseve të vendit.

Sipas reagimeve të para të bizneseve pjesa më e debatuar e projektit të vendosjes së arkave fiskale do të jetë çmimi i lartë i pajisjeve fiskale dhe monopoli në treg i dy kompanive të licencuara për shitjen e këtyre pajisjeve.

Procesi i pajisjes së biznesit me arka fiskale do të has në vështirësi veçanërisht te bizneset e vogla, i cili pretendon se çmimi kushtues i blerjes së arkave fiskale për ta është i lartë dhe i papërbalueshëm për arsye se shumica e bizneseve të vogla siç dihet nuk iu pranohet kjo blerje si shpenzim (fjala është për bizneset me qarkullim më të vogël se 50,000.00 Euro gjatë vitit kalendarik), tatimpaguesit shprehen se e kanë të pamundur të përballojnë koston e pajisjes, pasi siç dihet qarkullimi apo shitja ditore në këto vitet e fundit nuk është në nivelin e duhur sidomos pas krizës së vitit 2009 që e kaploi Evropën dhe remitencat nga mërgimtarët-diaspora janë zvogëluar dukshëm dhe niveli papunësisë në Kosovë siç dihet është shumë i lartë dhe në rritje e sipër.³

Prandaj, për funksionimin e këtij projekti dhe pajisjes sa më të shpejtë të tatimpaguesve me arka fiskale, Administrata Tatimore dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të rishqyrtojë edhe njëherë çmimin e këtyre pajisjeve, të rrisë konkurrencën në treg domethënë të licencojë edhe kompani tjera për shitjen dhe importimin e tyre. Konkurrenca apo tregu i hapur ndikon edhe në çmim edhe në kualitet.

Nuk do të duhej lejuar krijimin e vakumit në mes bizneseve të pajisura me arka fiskale dhe atyre që nuk duan që të pajisen, sepse në atë mënyrë vije në shprehje konkurrenca jo lojale dhe krijohet huti.

Dikush mund të lëshojë kupon tatimor nga arka fiskale, ndërsa dikush lëshon në formë të shkruar apo nuk lëshon fare kupon-fakturë tatimore. Pra sipas dëshirës. Imponimi i këtyre gjërave do të pamundësonte eliminimin e mallrave pa origjinë dhe kjo do të vlente sidomos për mallin e kontrabanduar në veriun e Kosovës dhe zhdukjen sa më të madhe të evazionit tatimor.

2.1.4. Disa analiza te efekteve globale ekonomike ne ekonomine e Kosoves

Ekonomia botërore i është nënshtruar një stresi të konsiderueshëm ekonomik që nga mesi i vitit 2008. Me krizën e pengjeve të këqija e cila u shndërrua në krizë të plotë financiare, efekti në sektorin real ka filluar të ndjehet në tërë botën. Si rezultat i kësaj, tkurrja ekonomike ka shkaktuar rënie të theksuar në tregtinë ndërkombëtare dhe në prodhimin industrial e cila gjë më tutje ka qar në nivele historike të papunësisë. Ndonëse pasojat më së shumti janë ndier në vendet e zhvilluara, ekzistojnë rreziqe të dukshme të cilat e kërcënojnë zhvillimin ekonomik të vendeve në zhvillim.

Për dallim prej pjesës më të madhe të botës së zhvilluar, Kosova ka qenë e kursyer nga efektet fillestare që i ka përjetuar ekonomia botërore. Niveli i lartë i absorbimit vendor në Kosovë është financuar në masë të madhe nëpërmes remitencave dhe përkrahjes së donatorëve.

Rreziqet potenciale në financim janë:

Pagat e shërbyesve publik dhe rritja e pagave – Gjatë vitit 2008, Qeveria ka sjell vendim që ti rris pagat dhe mëditjet për shërbyesit publik për 10% duke filluar nga 1 janari

³ <http://www.telegrafi.com/?id=49&a=198>

2009. Kjo ka rritur faturën e pagave për €14.8 milionë gjatë vitit 2009 (pa përfshirë rritjen e pagave për mësimdhënës), duke e shkelur kështu rregullën fiskale të dakorduar me FMN-n. Ka pasur një prospekt për rritje të mëtejshme prej 5% në 2010 dhe 2011. 5% shtesë gjatë vitit 2010 do të kërkonin financim shtesë buxhetor, e cila gjë do të shtynte buxhetin në një pozitë të pafavorshme fiskale.

Importi i energjisë – KEK-u aktualisht pranon subvencione substanciale nga buxheti. Qeveria është pajtuar që viti 2010 të jetë viti i fundit ku sektori i energjisë do të subvencionohet. Mirëpo, vendimi se si do të ecet me Kosovën A dhe B ende është në pritje. Nëse aty do të ketë vonesë, subvencionet e mëtutjeshme për energji do të jenë të nevojshme.

Huaja për KEK-un – Qeveria e Kosovës i ka dhënë një hua KEK-ut në vitin 2008 në vletë €79.4 milionëve nga të cilat vetëm €8.7 milionë janë shpenzuar gjatë këtij viti. Pjesa e mbetur është bartur në vitin 2009. Kjo kredi është shoqëruar nga €80 milionë shtese në buxhetin e vitit 2009 dhe €37.9 milionë për vitin 2010 për hapjen e minierës së re. Ky dokument parasheh se tërë shuma do të kthehet gjatë vitit 2010.

Performanca financiare e KEK-ut – edhe përkundër përmirësimeve të bëra gjatë vitit 2008, KEK-u vazhdon të krijoj të hyra të pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të veta kapitale dhe operative. Nga kjo perspektivë, vendimi potencial për ti mbajtur termocentralet Kosova A dhe B në pronësi të qeverisë, do të bënte të domosdoshme buxhetimin shtesë për financimin e investimeve kapitale në këto dy termocentrale.

Rezerva e stabilizimit –FMN rekomandon që Qeveria duhet të rris rezervën e saj të stabilizimit në 9% të BPV-së (€375 milion në vitin 2010). Në këtë kontekst Qeveria ka vendosur që ta rris rezervën e stabilizimit nga €50 milionë sa ka qenë në vitin 2008 në €200 milionë, që është ende më e ulët krahasuar me nivelin e rekomanduar nga FMN-ja. Nëse rekomandimi i FMN-së respektohet në mënyrë të plotë, kjo në masë të dukshme do ta ndryshonte imazhin makro-fiskal.

Anëtarësia në FMN dhe Bankë Botërore – Anëtarësia e pritur e Kosovës në FMN dhe BB do të krijoj obligime financiare shtesë për qeverinë. Pagesa e kështit të parë të parapagimit që kap shumën e €37 milion duhet të paguhet me nënshkrimin e anëtarësisë, gjersa vlera totale e shumës që duhet paguar (€154 milion) duhet të bëhet brenda 6 muajve pas nënshkrimit.

Indeksimi i pensioneve – rekomandimi kryesor që del nga dokumenti i fundit për politikën sociale (letra e bardhë) i hartuar nga grupi punues ndër-qeveritar është indeksimi i skemave pensionale dhe të asistencës sociale për vlerë të inflacionit. Implementimi i këtij rekomandimi do të rezultonte me kosto shtesë buxhetore në vlerë të rreth €20 milionë në vit.

Shëndetësia – financimi i qëndrueshëm dhe i mjaftueshëm i sektorit shëndetësor është rekomandim tjetër që del nga Letra e Bardhë. Ky dokument sugjeron që buxheti për shëndetësi të shtohet për rreth €30 milion krahasuar me shumën e aprovuar për vitin 2009. Në të njëjtën kohë, buxheti parasheh implementimin e Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili kërkon mjete shtese.

Policia – Zbatimi i plotë i Ligjit të Shërbimit Policor të Kosovës do të kërkoj buxhet shtesë prej 10 milion eurove.⁴

Faktorët me ndikim pozitiv janë:

Një numër i faktorëve sugjerojnë se ka një shkallë të hapësirës në dispozicion të vendimmarrësve politik që të mund të ballafaqohen me balancën fiskale që ka mundësi të dëmtohet. Këta faktor kanë të bëjnë me deklarinin potencial të dividendit të madh të PTK-së dhe privatizimin e mundshëm të PTK-së, njësisive të furnizimit dhe distribucionit të KEK-ut, sikurse edhe ndihma e premtuar e donatorëve.

Dividenda e PTK-së – Pasi që PTK është ndërmarrje në pronësi publike, qeveria mbetet aksionari i saj kryesor. PTK deri me tani ka vërtetuar se është ndërmarrje që krijon profit të konsiderueshëm, e cila ka kontribuar shumë në buxhetin e Kosovës nëpërmes të pagesës së tatimeve, tatimit special që ka paguar më herët për shkak të pozicionit të saj monopolist në treg dhe nëpërmes të mundësisë së qeverisë që ta marr dividendin. Për shkak të zbrazjes së shpejtë të balancës bankare për të ofruar një ventil për deficitet fiskale përgjatë periudhës së projektuar, si dhe për shkak të nevojës që të mbahen shpenzimet kapitale publike në nivelin e afërsisht €400 milion në vit, deklarimi i dividendës së PTK-së nga qeveria mbetet si opsion i cili do të mundet potencialisht të shërbej për mbulimin e boshllëkut financiar. Nëse deklarohet në tërësi, dividenda e PTK do të kap shumën prej rreth €150 milion, duke përbërë kështu një burim substancial të të hyrave për qeverinë. Mirëpo, shumica e profitit të PTK-së është depozituar në bankat lokale. Si rezultat i kësaj, qeveria është vetëdijshme se nëse e deklaron dividendin, mund të ndikoj në nivelin e likuiditetit të sektorit financiar.

Privatizimi i PTK-së – Qeveria është deklaruar në favor të privatizimit në NPP-ve kryesore, si mënyrë për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe futjen e logjikës së tregut dhe asaj komerciale në industrinë kyçe. Si rezultat, përveç futjes në treg të operatorit të dytë të telefonisë mobile në vitin 2007 që ka ndikuar në krijimin e konkurrencës në tregun e telekomunikacionit, PTK si e tërë pritet të privatizohet në një të ardhme të afërt. Përfundimi i këtij procesi mund të rezultojë me shitjen e asetëve në vlerën e rreth €500 milion. Ky burim substancial i financave mund të shfrytëzohet për financimin e shpenzimeve publike që janë në rritje.

Furnizimi dhe distribucioni i KEK-ut – qeveria është zotuar në mënyrë të fuqishme se do të procedoj me privatizimin e sektorit energjetik duke e ndjekur strategjinë dy shkallore. Së pari, të ndërtohen kapacitetet e reja për prodhimin e energjisë nëpërmes përfshirjes së kompanive të mëdha energjetike ndërkombëtare si investuese kryesore. E dyta, për përmirësimin e situatës aktuale në sektorin e energjisë, është sjell vendimi për privatizimin e asetëve ekzistuese duke ja shitur njësitë e furnizimit dhe distribucionit investuesve privat. Logjika që qëndron pas kësaj është se sektori privat do të vendoste logjikën komerciale në operacionet e KEK-ut dhe do ta fuqizonte kapacitetin e mbledhjes së pagesave. Shitja e asetëve ekzistuese të KEK-ut në njësitë e furnizimit dhe distribucionit do të kapnin vlerën potenciale në mes të €30-€50 milion.

Përkrahja buxhetore – Konferenca e donatorëve për Kosovën 2008 ka nxitur zotime substanciale të donatorëve të ndërlidhura jo vetëm me mbështetjen direkte buxhetore, por

⁴ Marredhenit ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale në Kosovë

gjithashtu edhe me financimet e projekteve kapitale jashtë buxhetore dhe me pagesën e borxhit të jashtëm të Kosovës. Mbështetja direkte buxhetore e zotuar kapë shumën e €208 milionë për tre vitet e ardhshme.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Debati publik mbi tatimet dhe politikën fiskale është pjesë e një debati të gjerë mbi politikën e tregtisë në Kosovë. Përqendrimi kryesor është rreth nivelit të taksave doganore dhe tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Politika fiskale është pjesë e politikës së përgjithshme ekonomike, që në Kosovë synon krijimin e një ekonomie funksionuese që bazohet në treg. Nivelet e tatimit në Kosovë, si edhe gjetiu, janë rezultat i një detyre të ndërlikuar balancuese ndërmjet nevojave të buxhetit dhe efekteve të tatimeve në zhvillimin ekonomik.

Ndërsa tatimet janë barrë e kompanive dhe ekonomisë, të ardhurat që ato i krijojnë i financojnë shërbimet publike që janë të nevojshme për aktivitetin ekonomik. P.sh. qeveria mirëmban rrugët që kompanitë i shfrytëzojnë për ta sjellë lëndën e parë dhe për t'i transportuar produktet e tyre përfundimtare, dhe shkollat publike ofrojnë arsim që u siguron ndërmarrjeve nëpunës të kualifikuar për të cilët ato kanë nevojë.

Shumica e investimit kapital në shërbimet publike në Kosovë ende financohet nga donatorët, kontributet e të cilëve janë duke u zvogëluar gradualisht pasi Kosova po merr përsipër gjithnjë e më tepër përgjegjësi. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës duhet të zhvillohet për të qenë në gjendje që t'i marrë përsipër nevojat e financimit për këto shërbime thelbësore.

Bizneset do të dëshironin ta shihnin heqjen e taksave doganore për mallrat kapitale dhe për lëndën e parë, e jo për produktet e destinuar për konsumim. Institucionet financiare ndërkombëtare nuk e favorizojnë zbatimin e një sistemi të tillë të dyfishtë. Një arsye është se ajo do t'i inkurajonte prodhuesit vendorë për të prodhuar vetëm për tregun e brendshëm të

mbrojtur dhe do t'i parandalonte që të ishin të detyruar të ballafaqoheshin me konkurrencën rajonale dhe ndërkombëtare. Sistemi i dyfishtë gjithashtu do ta shtonte rrezikun e klasifikimit të gabuar të mallrave dhe të korrupsionit. Administrimi i tij do të kërkonte kapacitet të shtrenjtë plotësues në Administratën Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Në përgjithësi, Kosova ka nivele të ulëta të tatimeve. TVSH-ja në Kosovë është më e ulëta në rajon, më e ulët se shkalla standarde minimale që zbatohet në Bashkësinë Evropiane. Importet nga Maqedonia dhe eksportet për në Maqedoni nuk ngarkohen me taksa doganore (përveç 1% taksa administrative), njësoj si ato që vijnë nga Serbia dhe Mali i Zi dhe që shkojnë në Serbi dhe Mal të Zi. Marrëveshja e re për tregti të lirë me Shqipërinë, që hyri në fuqi koheve të fundit, parashikon heqjen e menjëhershme të taksave doganore për prodhime të caktuara dhe zvogëlimin gradual për artikuj të tjerë të përdorimit të gjerë.

Pasi TVSH-ja dhe tatimet e tjera të bëhen burime më të rëndësishme të të ardhurave, taksa doganore prej 10% do ta humbasë rëndësinë e vet si krijuese e të ardhurave. Por shumë ekspertë duket se pajtohen se edhe tani ekzistojnë faktorë më të rëndësishëm që mund ta stimulojnë prodhimtarinë vendore dhe eksportet, si sistemi i zbritjes së taksave doganore për mallra kapitale dhe inpute të mesme që përdoren për prodhimin e mallrave për eksport. Për ta zbatuar një sistem të tillë, Administrata Tatimore duhet të përmirësohet në mënyrë që kompensimet e TVSH-së të përshpejtohen. Edhe sektori bankar do të mund të inkurajohej për të lejuar kredi për tregti.

Por, për t'i ndihmuar sistemit fiskal të Kosovës që ta zhvillojë dhe inkurajojë prodhimtarinë vendore, prodhuesit duhet t'i përmirësojnë praktikën e tyre të mbajtjes së kontabilitetit dhe të ndajnë më tepër informata me autoritetet tatimore.

4. METODOLOGJIA

Duke pasur parasysh mungesën e informatave dhe pamundësisë së shfrytëzimit të burimeve të ndryshme në mënyrë më racionale, për nevoja të punimit “Politikat Fiskale në Kosovë” pos referimeve të bëra në literaturën e mbledhur të dhënat tjera janë mbledhur me anë të intervistës.

Intervista është realizuar me anë të pyetësorëve dhe gojarisht. Të intervistuarit kanë qenë pronar të bizneseve nga të gjitha njësitë rajonale të Kosovës. Pyetësi, ishte i ndarë në disa kapituj duke u bazuar në fushat nga të cilat mund të rrjedhin barrierat për bizneset përfshirë këtu: tatimet, doganat, sistemin bankar etj. Pyetësi ka qenë i formuluar në dy gjuhë: Shqipe dhe Angleze, është kërkuar përgjigje në aspektin konkurrenca të firmës si dhe përfitimet dhe dëmet të cilat rrjedhin nga tatimet, doganat, konkurrenca jolojale si dhe sygjerimet për përmirësimet në të ardhmën etj.

Informatat shpesh përveç pyetjeve në pyetësor të nevojshme për punën në vazhdimësi të hulumtimit do të regjistrohen me lejen e pjesëmarrësve të intervistës, këto të dhëna do të na shërbejnë gjatë rrugëtimit të ardhshëm.

Kjo intervistë është realizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës nga persona kompetent të kësaj lirie që të realizojnë këtë intervistë për një periudhë të caktuar kohore, në intervistë kanë qenë pjesëmarrës 252 kompani të ndryshme nga rajone të ndryshme të Kosovës dhe është synuar që në fund me analizimin e këtyre të dhënave të nxjerrin një përfundim të

caktuar i cili do të publikohet e njëkohësisht do të mund të përdoret në hulumtimet e ardhshme.

Intervista është realizur me drejtor xheneral apo edhe me menaxher financiar të kompanive të ndryshme në Kosovë.

5. REZULTATET

Kjo analizë bazohet në një mostër prej gjithsej 252 respondentë. Gjatë trajtimit të disa çështjeve jo të gjitha bizneset kanë dhënë përgjigje. Për këtë arsye numri total i respondentëve do të jetë më i vogël se 252. Respondentët janë persona kompetentë për këtë lami, të cilët janë caktuar nga bizneset përkatëse që shtrihen në të gjitha njësitë rajonale të Kosovës. Instrumenti i analizës ishte pyetësori, i cili është i ndarë në disa kapituj duke u bazuar në fushat nga të cilat mund të identifikoheshin: barrierat për bizneset (përfshirë këtu: tatimet, doganat, sistemin bankar etj). Prezantimi i rezultateve do të bëhet sipas strukturës së pyetësorit.

I. Niveli i kënaqësisë me infrastruktuën në përgjithësi

Tabela 1. Niveli i kënaqësisë së bizneseve me infrastruktuën (%)

	Pak i kënaqur	Mesatarisht i kënaqur	Shumë i kënaqur
Energjia elektrike	57.26	34.27	8.47
Infrastruktura rrugore	25.40	70.2	4.4
Telekomunikacioni	6.5	58.3	35.2
Tatimet	38.53	56.43	5.04
Normat e interesave	83.6	8.40	8

bankare			
Infrastruktura ligjore	60.8	37.6	1.6

Pengesat dhe problemet kryesore me të cilat ballafaqohen bizneset

Tabela 2. Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen bizneset (%)

Problemet	Përqindja e respondentëve
Konkurrenca jolojale	30.6
Energjia elektrike	17.7
Tatimet	11.5
Doganat	11
Normat e interesit	9.6
Infrastruktura ligjore	8.1
Importi I pakontrolluar	7.6
Infrastruktura	5.3
Tregu I zi	4.8
Parregullsi në tendere	3.8
CEFTA	2.9
Papunësia	2.4
Konkurrenca nga jashtë	2.4
TVSH	1.9
Korrupsioni	1.4
Përkrahja shtetërore/ subvencionet	1.4
Uji	1.4
Barierat Jotarifore	0.9
Akciza	0.9
Inkasimi	0.9
Piratëria	0.5
Kriza globale	0.5
Likuiditeti	0.5
Eksporti	0.5
Infrastruktura rrugore	0.5

II. Administrata Tatimore

Tabela 3. Niveli i kënaqësisë me kohën e inspektimit tatimor (%)

Niveli i kënaqësisë	Përqindja e respondentëve
Pak i kënaqur	23.3
Mesatarisht i kënaqur	65.7
Shumë i kënaqur	11

Tabela 4. Niveli i kënaqësisë me sjelljen dhe punën e inspektorëve tatimorë (%)

	Përqindja e respondentëve
Niveli i kënaqësisë	
Pak i kënaqur	15.2
Mesatarisht i kënaqur	68.8
Shumë i kënaqur	16

Tabela 5. Mendimi i bizneseve lidhur me lartësinë e normave tatimore që hyjnë në fuqi më 01.01.2009 (%)

	Përqindja e respondentëve
Të ulta	4
Mesatarisht të ulta	65.2
Të larta	30.8

Tabela 6. Mendimi i bizneseve lidhur me procedurat e paraqitjes dhe pagimit të tatimeve (%)

	Përqindja e respondentëve
Të thjeshta	15.5
Mesatarisht të thjeshta	68.7
Të komplikuar	15.8

III. Administrata Doganore

Tabela 7. Niveli i kënaqësisë me procedurat e zhdoganimit (%)

	Përqindja e respondentëve
Pak	20
Mesatarisht	61.7
Shumë	18.3

Tabela 8. Mendimi rreth kompleksitetit të procedurave të zhdoganimit dhe të pagimit të tatimeve (%)

	Përqindja e respondentëve
Të thjeshta	9.2
Mesatarisht të thjeshta	66.8
Të komplikuara	24

Tabela 9. Vlerësimi për sjelljet dhe punën e doganierëve (%)

	Përqindja e respondentëve
Të këqija	16.2
Normale	75
Të mira	8.8

Tabela 10. Mendimet e bizneseve rreth lartësisë së tarifave doganore (%)

	Përqindja e respondentëve
Të ulëta	0.9
Mesatare	48
Të larta	51.1

6. KONKLUZIONET

Ndërhyrja e shtetit në rrjedha ekonomike përmes politikës fiskale arsyetohet me rregullimet e bëra në drejtim të mënjanimin të dukurive që bëhen pengesë për ruajtjen e mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë. Këto dukuri lidhen me veprimin joperfekt të tregut në: mbrojtjen e shtresave të varfra të shoqërisë, krijimin e vendeve të punës, evitimin e monopoleve dhe rritjen e konkurrencës së mirëfilltë, rishpërndarjen më të drejtë të pasurisë, e tjerë.

Politika fiskale përbën një komponentë të politikës ekonomike shtetërore që shfrytëzohet për qëllime makroekonomike për ta ndikuar nivelin e produktit, punësimit dhe çmimeve

Duke u bazuar në të dhënat më lartë qoftë të marruara nga literaturat të ndryshme qoftë nga rezultatet e intervistës, mund të vijmë në një përfundim ku mund të themi se normat tatimore në Kosovë të cilat aktualisht janë nga ana e bizneseve shihen si norma tatimore mesatare si dhe shihet krijimi i një fryme të favorshme për zhvillimin e vendit, si dhe mundësinë për zhvillimin apo ndryshime në disa segmente.

Në Kosovë mbledhja e të hyrave buxhetore kryesisht realizohet përmes dy institucioneve kryesore: Administratës Tatimore të Kosovës si dhe Shërbimit Doganor të Kosovës.

Gjate gjithë periudhës këto institucione kanë shënuar rezultate të kënaqshme në mbledhjen e të hyrave tatimore, si dhe në uljen e nivelit të evazionit fiskal.

Kosova ka ndërtuar një politikë të shëndoshë fiskale përmes së cilës është tentuar të ndikohet në stimulimin e rritjes ekonomike si dhe krijimin e stabilitetit të përgjithshëm fiskal. Kjo politikë ka bërë që deri më tani të sigurohet një qëndrueshmëri financiare si rezultat i gjenerimit të konsiderueshëm të të hyrave, përderisa nga aspekti i shpenzimeve në vazhdimësi është arritur përmirësimi dhe rritja e shkallës së ekzekutimit të shpenzimeve. Të hyrat e mbledhura edhe më tutje nuk reflektojnë një ngarkesë të madhe për ekonominë, pasi që ato edhe më tutje sillen në nivelin prej 23% të BPV-së. Rritja e shpenzimeve kapitale ka bërë që gjatë vitit të kaluar burim i rëndësishëm i rritjes ekonomike të jenë investimet publike.

Kosova në tre vjetet e ardhshme pritet të ballafaqohet me rritje të vazhdueshme të deficitit, i cili pa ndihmën financiare të donatorëve dhe privatizimin e ndermarrjeve publike do të mund të shkaktojë probleme të mëdha për ekonominë kosovare. Të hyrat buxhetore të planifikuara për tre vjetët e ardhshme janë rreth 1.2 miliard euro për secilin vit, ndërkaq shpenzimet pritet të tejkalojnë shifrën prej 1.4 miliard euro duke krijuar një deficit të dukshëm sidomos në vitin 2011.

Deficiti prej 144 milion euro në vitin 2010 do të shtohet duke arritur shifrën 310 milion euro në vitin e ardhshëm. Ekspertet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave thonë se Kosova për të marrë ndihmë nga donatorët duhet të rrisë llogaridhënien dhe kapacitetet administrative.

Për periudhën e ardhshme 2011- 2013 pozita e përgjithshme fiskale parashihet të dobësohet për shkakë të planifikimeve për rritje të shpenzimeve publike, gjithashtu është parashikuar që deficitin në rritje të mbështetet nga bilanci i akumuluar në vitet paraprake si dhe nga paratë e donatorëve dhe huat e reja. Viti më i vështirë përse i përket pozitës fiskale do të jete viti 2011.

Rruga fiskale për Kosovën gjatë kësaj periudhe do të jetë e vështirë sepse Kosova do të duhet të sigurojë arkëtim më të mirë të të hyrave ose mbështetje financiare në të kundërtën do të jetë e detyruar të ndryshojë prioritetet e shpenzimeve publike.

Për vitin 2010 pjesa më e madhe e buxhetit do të përdoret për sektorin e zhvillimit ekonomik i cili do të marrë rreth 33% të buxhetit, i dyti do të jetë sektori i mirëqenies sociale dhe i shëndetësisë i cili do të apsorboj rreth 27% të buxhetit. Ministria e Transportit sërish do të ketë të hyrat më të larta të cilat në vitin 2012 do të arrijnë në 312 milion euro për shkakë të projekteve të reja kapitale të cilat janë parashikuar të realizohen në këtë periudhë.

Të hyrat vendore nga taksat do të jenë më të ulta krahasuar me të hyrat nga doganat, kështu të hyrat nga tatimet e mbrendshme do të jenë rreth gjysëm miliard euro me të ulta krahasuar me të hyrat të mbledhura nga doganat.

7. REKOMANDIMET

Jo rrallë ngjan që shteti del i paaftë në drejtimin e politikës fiskale qoftë për shkak të informacioneve jo të sakta apo parashikimeve të gabuara lidhur me efektet që rezultojnë nga masat dhe veprimet e ndërmarra për arritjen e objektivave të politikës fiskale.

Andaj, planifikimi dhe implementimi i politikës fiskale të drejtë për kohën kur ajo duhet të përdoret, jep mundësi të shumta për zhvillimin e ekonomisë së një vendi.

Pa prekur dhe elaboruar më thellë çështjet e ndjeshme në aspektin mikro dhe makroekonomik, qeveria dhe institucionet tjera relevante të Kosovës duhet të bëjnë njoftimin e drejtpërdrejtë të prodhuesve lidhur me përfitimet të cilat ofron legjislacioni në fuqi, veçanërisht legjislacioni lidhur me procedurat doganore, organizimin e seminareve, trajnimeve dhe informimeve shumë më të shpeshta për komunitetin e biznesit lidhur me këto lehtësira.

Duhet krijuar një trup zyrtar qeveritar i përbërë nga ekspertë nga lëmitë ekonomike, doganat dhe tatimet, ku detyrë primare e tyre do të ishte informimi dhe ndihma e drejtpërdrejtë e komunitetit të biznesit për sfidat e reja të cilat i presin ata.

Të shqyrtohet politika fiskale e vendeve përreth, sa është taksa e TVSH-së në ato vende. Sipas informatave ekszituese TVSH në vendet përreth është më e lartë se në Kosovë si psh. në Shqipëri është 20%. Kjo nënkupton se kompanitë e huaja prodhuese janë në pozitë

më të favorshme se vendoret në tregun kosovar i cili me këtë nivel të TVSH-së do të jetë më joshësi.

8. REFERENCAT

- Dornbusch, R. dhe Fischer, S. (2000). Makroekonomia, Dituria, 2000, Tiranë.
- Limani, M. (2008). Makroekonomia Aplikative, Prishtinë.
- Mancelleri, A. Haderi, S. Kule, Dh. Dhe Qirici, S. (1999). Hyrje në Ekonomi, Pegi, 1999, Tiranë.
- Minxhozi, L. (2007). Ekonomia- Mikroekonomi dhe Makroekonomi (Tekst për fakultetet ekonomik, juridik dhe të shkencave politike), Tiranë, 2007.
- Pano, A. (2002). Fjalor Ekonomiko- Financiar, Albin, 2002, Tiranë.
- Sinai, A. (2009). “Macroeconomic Effects”, Dcision Economic Inc., Neë York, Jan. 30.2009.
- Samuelson, P dhe Nordhaus, W. (2001). Economic, McGraw-Hill, 2001, New York.
- Gregory, M. (2003). Macroeconomic 5th, Worth, 2003, New York.
- www.cepr.org, “Fiscal Policy and Crisis”, IMF Staff Position Note, Dec. 29, 2008, SPN/08.

www.mfe-ks.org “Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2008-2010”

www.bqk-kos.org “Buletini i Pagesave”

Oda Ekonomike e Kosovës. (2007) “Sfidat e Bizneseve” <http://en.wikipedia.org/wiki/CEFTA>

Doing Business 2010

Organizata per siguri dhe bashkepunim ne Evrope – Misioni ne Kosove, Marredheniet ndermjet autoriteteve qendrore dhe lokale ne Kosove, shkurt 2008.

Deficiti Buxhetore do te dyfishohet brenda nje viti – Koha Ditore, faqe. 8 - 31.05.2010.

9. SHITESAT

Sfidat e Bizneseve – te dhenat nga intervista e realizuar.

I. Niveli i kënaqësisë me infrastruktuën në përgjithësi

Tabela 1. Niveli i kënaqësisë së bizneseve me infrastrukturën (%)

	Pak i kënaqur	Mesatarisht i kënaqur	Shumë i kënaqur
Energjia elektrike	57.26	34.27	8.47
Infrastruktura rrugore	25.40	70.2	4.4
Telekomunikacioni	6.5	58.3	35.2
Tatimet	38.53	56.43	5.04
Normat e interesave bankare	83.6	8.40	8
Infrastruktura ligjore	60.8	37.6	1.6

Tabela 2. Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen bizneset (%)

Problemet	Përqindja e respondentëve
Konkurrenca jolojale	30.6
Energjia elektrike	17.7
Tatimet	11.5
Doganat	11
Normat e interesit	9.6
Infrastruktura ligjore	8.1
Importi I pakontrolluar	7.6
Infrastruktura	5.3
Tregu I zi	4.8
Parregullsi në tendere	3.8
CEFTA	2.9
Papunësia	2.4
Konkurenca nga jashtë	2.4
TVSH	1.9
Korrupsioni	1.4
Përkrahja shtetërore/ subvencionet	1.4
Uji	1.4
Barierat Jotarifore	0.9
Akciza	0.9
Inkasimi	0.9
Piratëria	0.5
Kriza globale	0.5
Likuiditeti	0.5
Eksporti	0.5
Infrastruktura rrugore	0.5

II. Regjistrimi i biznesit

Tabela 3. Niveli i kënaqësisë me kohën e regjistrimit ose të ndryshimeve në regjistrimin e bizneseve (%)

Niveli i kënaqësisë	Përqindja e respondentëve
Pak i kënaqur	19.1
Mesatarisht i kënaqur	72.4
Shumë i kënaqur	8.5

Tabela 4. Niveli i kënaqësisë me procedurat e regjistrimit ose të ndryshimeve eventuale të bizneseve (%)

Niveli i kënaqësisë	Përqindja e respondentëve
Pak i kënaqur	15.5
Mesatarisht i kënaqur	77.5
Shumë i kënaqur	7

III. Administrata Tatimore

Tabela 5. Niveli i kënaqësisë me kohën e inspektimit tatimor (%)

Niveli i kënaqësisë	Përqindja e respondentëve
Pak i kënaqur	23.3
Mesatarisht i kënaqur	65.7
Shumë i kënaqur	11

Tabela 6. Niveli i kënaqësisë me sjelljen dhe punën e inspektorëve tatimorë (%)

Niveli i kënaqësisë	Përqindja e respondentëve
Pak i kënaqur	15.2
Mesatarisht i kënaqur	68.8
Shumë i kënaqur	16

Tabela 7. Mendimi i bizneseve lidhur me lartësinë e normave tatimore që hyjnë në fuqi më 01.01.2009 (%)

	Përqindja e respondentëve
Të ulta	4
Mesatarisht të ulta	65.2
Të larta	30.8

Tabela 8. Mendimi i bizneseve lidhur me procedurat e paraqitjes dhe pagimit të tatimeve (%)

	Përqindja e respondentëve
Të thjeshta	15.5
Mesatarisht të thjeshta	68.7
Të komplikuara	15.8

IV. Administrata Doganore

Tabela 9. Niveli i kënaqësisë me procedurat e zhdoganimit (%)

	Përqindja e respondentëve
Pak	20
Mesatarisht	61.7
Shumë	18.3

Tabela 10. Mendimi rreth kompleksitetit të procedurave të zhdoganimit dhe të pagimit të tatimeve (%)

	Përqindja e respondentëve
Të thjeshta	9.2
Mesatarisht të thjeshta	66.8
Të komplikuar	24

Tabela 11. Vlerësimi për sjelljet dhe punën e doganierëve (%)

	Përqindja e respondentëve
Të këqija	16.2
Normale	75
Të mira	8.8

Tabela 12 Mendimet e bizneseve rreth lartësisë së tarifave doganore (%)

	Përqindja e respondentëve
Të ulëta	0.9
Mesatare	48
Të larta	51.1

V. Tregu

Tabela 13. Mendimi rreth cilësisë së produkteve që ofrohen në treg (%)

	Përqindja e respondentëve

Jo të mira/Jokualitative	29
Të mira/Kualitative	25.2
Mesatare	21.5
Të pakontrolluara	13
Të dyshimta/Jo të sigurta	10.7
Varet nga cmimi/kompania etj.	2.3

Tabela 14. Mendimi rreth liberalizimit të tregut në Kosovë – sa do të rrezikohej biznesi nga konkurrenca e jashtme (%)

	Përqindja e respondentëve
Pak	18.3
Mesatarisht	33.7
Shumë	48

VI. Sistemi bankar

Tabela 15. Niveli i kënaqësisë me punën e bankave (%)

	Përqindja e respondentëve
Pak i kënaqur	27.3
Mesatarisht i kënaqur	58
Shumë i kënaqur	14.7

Tabela 16. Niveli i kënaqësisë me normat e interesave bankare (%)

	Përqindja e respondentëve
Pak i kënaqur	85.4
Mesatarisht i kënaqur	11.6
Shumë i kënaqur	3

Tabela 17. Niveli i besimit në bankat që operojnë në Kosovë (%)

	Përqindja e respondentëve
Pak	19.2
Mesatarisht	66.5

Shumë	14.3
-------	------

Tabela 18. Cfarë duhet nryshuar në aktivitetin e bankave (%)

Ndryshimet e nevojshme	Përqindja e respondentëve
Ulja e normave të interesit	90.5
Thjeshtimi I procedurave	13.8
Zgjatja e afatit të kthimit të kredive	9.9
Kredi të volitshme për investime kapitale/bujqësi/blegtori	6
Të ketë sjellje më të mira të punonjësve	2.6

VII. Të ndryshme

Tabela 19. Sa janë të nevojshme institucionet e standardizimit (%)

	Përqindja e respondentëve
Pak	6.5
Mesatarisht	23.7
Shumë	69.8

Tabela 20. Cfarë pengese në afarizëm ju paraqet mosekzistimi apo mosfunksionimi i institucioneve të standardizimit (%)

Pengesa	Përqindja e respondentëve
Konkurencë/Konkurencë jolojale	21.4
Pengesë në zhvillimin e biznesit	19.1
Humbje e besimit të klientëve në cilësinë e produktit	16
Pengesë në eksport	16
Nuk ka ndikim	13.7

Rekomandimet për përmirësimin e ambientit afarist

Tabela.21. Rekomandimet për përmirësimin e ambientit biznesor sipas shpeshtësisë

Rekomandimi	Shpeshtësia (Frekuenca)
Subvencione	31

Doganat në veri/Organet paralele	24
Infrastruktura ligjore	22
Politika Fiskale	19
Infrastruktura në përgjithësi	18
Normat e interesit	17
Doganat	17
Tregu	12
Energjia elektrike	12
Konkurrenca jolojale	6
Infrastruktura rrugore	6
Rregullat e tenderimit	5
Kontrolli i importit	5
Favorizimi i prodhimeve vendore	4

Në tabelën 21 janë paraqitur rekomandimet e pronarëve të bizneseve për përmirësimin e ambientit biznesor në Kosovë. Kolona e dytë paraqet shpeshësinë e rekomandimit, gjegjësisht numrin e biznesmenëve, të cilët e kanë dhënë atë lloj rekomandimi. Rekomandimet më të shpeshta që propozon komuniteti i biznesit përfshijnë kërkesën për ndihmë nga shteti me anë të subvencionimeve (31 biznese), kontroll më efikas në doganat në veri (24 biznese), funksionimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ligjore (22 biznese).

Një numër relativisht i madh (19 biznese) rekomandojnë ndryshimin e politikës fiskale duke vecuar uljen e tatimeve, pagesën e TVSH pas shitjes, si dhe uljen e tarifave doganore. Përmirësimi i infrastrukturës së përgjithshme është një tjetër rekomandim i paraqitur nga (18 biznese), ndërsa ndër të tjera rekomandime janë ulja e normave të interesit për kredi (17 biznese), funksionimi efikas i doganave (17 biznese), krijimi i tregut më funksional (12 biznese) për një ambient më të përshtatshëm biznesi. Gjithashtu, biznesmenët kosovarë (12 biznese) rekomandojnë që të ketë një zgjidhje përfundimtare në lidhje me energjinë elektrike. Duhet luftuar konkurrenca jolojale që po shkatërron tregun (6 biznese). Një pjesë e bizneseve (6 biznese) shohin infrastrukturën rrugore si fushë në të cilën përmes investimeve qeveria do të ndihmonte në përmirësimin e ambientit biznesor.

Bizneset janë të preokupuara edhe me cilësinë e produkteve që importohen dhe sugjerojnë që të ketë rregullsi në proceset e tenderimit dhe që më shumë të konsumohen dhe të favorizohen prodhimet vendore.

Në kuadër të rekomandimeve nuk mungon as propozimi për themelimin e një banke investive, e cila do të mundësonte marrjen e kredive me kamata më të volitshme për bizneset. Po ashtu, komuniteti i biznesit rekomandon ndërtimin e zonave industriale, përkrahje në implementimin e marrëveshjes CEFTA, angazhim për lehtësimin e procedurave për viza për biznesmenët, si dhe komunikim të mirëfilltë mes institucioneve shtetërore dhe komunitetit të biznesit.

